



Tiranë, më 12.05.2015

RREGULLORE

**PËR ZHVILLIMIN E KONKURSIT TË PRANIMIT
NË PROGRAMET E CIKLIT TË PARË
"BACHELOR"
NË FAKULTETIN E ARTIT SKENIK,
NË UNIVERSITETIN E ARTEVE
PËR VITIN AKADEMIK 2015 – 2016**

MIRATUAR ME VENDIM NR 9, DATË 15.05.2015

TË SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT TË ARTEVE



Në zbatim të Ligjit Nr. 10307, datë 22.07.2010 për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin Nr. 9741, datë 21.05.2007 "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë " (i ndryshuar), Kreu IV, Organizimi i Studimeve në Institucionet e Arsimit të Lartë, Neni 33 Pranimi në ciklin e parë të studimeve, konkurset e pranimit në Fakultetin e Artit Skenik për vitin akademik 2015-2016 do të zhvillohen si më poshtë:

Neni 1

Pranimi i kandidatëve

- 1.1 Pranimi i kandidatëve në Fakultetin e Artit Skenik në Universitetin e Arteve, bëhen mbi rezultatin e konkurseve që zhvillohen pranë këtij Fakulteti, në të gjitha programet e studimit sipas kësaj Rregulloreje si dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve dhe pikëve totale të Maturës Shtetërore.
- 1.2 Kandidatët nga trojet Shqiptare jashtë kufijve që përfitojnë nga kuotat e veçanta Për Shqiptarët nga trevat jashtë kufijve të vendit si Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci dhe Medvegja, do të përzgjidhen mbi bazën e kësaj rregulloreje.
- 1.3 Përzgjedhja e tyre është e ndërvarur nga numri i kuotave të përcaktuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, posaçërisht për trojet Shqiptare.
- 1.4 Pikët e vlerësimit për çdo konkurrent do të ndahen sipas Udhëzimeve të MAS.

Neni 2

Procedura e organizimit dhe mbarëvajtjes së konkursit

- 2.1 Dekani i Fakultetit, mbështetur nga propozimet e Përgjegjësve të Njësive Bazë, merr masa dhe organizon ngritjen e Komisioneve të Pranimit për çdo program e Studimi.
- 2.2 Përbërja e Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit shpallet në ditën e fillimit të konkursit.
- 2.3 Në përbërjen të Komisionit të Pranimit aktivizohen:
 - I. Titullarë të fushës përkatëse,
 - II. Pedagogë efektivë të Departamenteve përkatëse,
 - III. Pedagogë të ftuar të Fakultetit, sipas nevojës për ato programe studimi ku nuk mund të mbulohen nga pikat I, II të këtij Neni.
- 2.4 Në përbërjen të komisionit nuk mund të jenë pedagogë apo persona të tjerë të cilët kanë bërë konsultime private lidhur me konkursin e pranimit apo janë në konflikt interesi.
- 2.5 Në ambientet ku zhvillohet konkursi nuk lejohet hyrja e personave të pa autorizuar nga Titullari i Fakultetit të Artit Skenik .
- 2.6 Për monitorimin e të gjithë procedurave të konkurrimit, që kanë të bëjnë me organizimin, administrimin, vlerësimin dhe shpalljen e rezultateve, Rektori i UART, me Urdhër të posaçëm ngre grupin përkatës, i cili monitoron cilësinë e zhvillimit të gjithë procedurave të konkurrimit në Fakultetin e Artit Skenik, si dhe nga përfaqësuesit e MAS.



Neni 3

Procedura e hyrjes së kandidatëve në mjediset e konkurrimit.

- 3.1 Kanë të drejtë të regjistrohen për në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së dërguar nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
- 3.2 Kanë të drejtë të hyjnë në konkurs të gjithë kandidatët sipas listës së regjistruar pranë Sekretarisë mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.
- 3.3 Konkursi për Fakultetin e Artit Skenik do të zhvillohet në ambientet e Fakultetit, sipas udhëzimeve të MAS.
- 3.4 Lejohen të hyjnë në konkurs vetëm kandidatët e listës së shpallur për konkurrim, të cilët duhet të jenë të pajisur me dokument identifikimi si më poshtë:
 - I. *Kartë Identiteti,*
 - II. *Pasaportë për jashtë shteti.*
 - III. *Kandidatët që nuk kanë asnjë nga këto dokumente identifikimi nuk do të pranohen të marrin pjesë në konkurs.*
- 3.5 Kandidati konkurrent për të hyrë në konkurs duhet të paraqesë në hyrje edhe mandat pagesën e bërë në llogari të Universitetit të Arteve. Kjo e bazuar në Udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.
- 3.6 Në varësi të specifikave për secilin Program Studimi komisionet do të punojnë paradite dhe pasdite me paraqitjet individuale të kandidatëve, duke i bërë të ditura më parë oraret përkatëse. Oraret duhet të shpallen në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik.
- 3.7 Oraret e fillimit të konkurseve, si dhe ambientet e zhvillimit të tyre do të jenë të shpallura në kalendarin e zhvillimit të konkurseve në ambientet e Fakultetit të Artit Skenik. Ky kalendar shpallet në Fakultet një javë përpara fillimit të konkursit.
- 3.8 Ditën e parë të konkursit pasi të jenë sistemuar në ambientet e zhvillimit të tij, kandidatëve u komunikohen rregullat e konkurrimit. Kjo bëhet nga Kryetarët e komisioneve përkatëse.
- 3.9 Sekretaria mësimore ju dorëzon me procesverbal Kryetarëve të Komisioneve të Programit të Studimit të gjitha materialet për konkurs, si dhe listat e konkurrentëve të regjistruar pranë kësaj sekretarie.
- 3.10 Bazuar në kriteret për secilin Program Studimi, komisionet krijojnë hapësirën kohore të nevojshme për shpërfaqjen individuale të kandidatëve gjatë konkurrimit.

Neni 4

Vlerësimi dhe shpallja e rezultateve

- 4.1 Vlerësimi për paraqitjen individuale të çdo kandidati bëhen nga Komisioni i Pranimi të Programit të Studimit, përbërja dhe numri i të cilit caktohen nga titullari i Fakultetit.
- 4.2 Numri i anëtarëve të komisionit në asnjë rast, nuk duhet të jetë më i vogël se 3 (tre).



- 4.3** Gjatë paraqitjes individuale të kandidatëve, anëtarët e jurisë mbajnë shënimet përkatëse. Po ashtu çdo anëtar i jurisë ka të drejtë t'i drejtojë kandidatit që konkurren kërkesa konkrete, të cilat i duken të arsyeshme për një shpërfaqje sa më të mirë të tij.
- 4.4** Mbas paraqitjes së kandidatit të fundit, në mbarim të gjithë seancave që parashikohen në kriteret e konkurrimit, Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, nën drejtimin e Kryetarit, mbledhen për të vlerësuar një për një paraqitjet e secilit kandidat. Vlerësimi përmban debatin si formë kryesore dhe në fund vendosjen e pikëve për secilin kandidat.
- 4.5** Pikët e mundshme në dispozicion të Komisionit të pranimit, shpërndahen në mënyrë të barabartë tek të gjithë anëtarët e komisionit. Secili anëtar vendos sasinë e pikëve përkrah emrit të kandidatit.
- 4.6** Komisioni i Pranimit të Programit të Studimit, në përfundim të vlerësimeve, përpilon listën e kandidatëve me pikët respektive në bazë të listës së sekretarisë mësimore. Lista në fund nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Pranimit.
- 4.7** Lista e nënshkruar si dhe shënimet e anëtarëve të komisionit të pranimit për çdo konkurrent, i dorëzohen me procesverbal titullarit të Fakultetit.
- 4.8** Komisionet e Programeve të Studimit në Fakultetin e Artit Skenik për mbarëvajtjen e konkursit marrin edhe këto masa :
- a) Aktrim**
Për secilin kandidat Komisioni i Pranimit të programit të studimit Aktrim xhiron me kamera njërin prej materialeve që e gjykon të arsyeshëm.
- b) Regji**
Komisioni depoziton në një dosje të veçantë platformën regjisoriale të gjithë kandidatëve për programin e studimit Regji. Po ashtu xhiron me kamera edhe njërin prej materialeve për secilin kandidat. Materialin e përcakton komisioni.
- c) Skenografi – Kostumografi**
Komisioni depoziton punimet e kryera gjatë ditëve të konkursit së bashku me dosjet personale për secilin kandidat për programin e studimit Skenografi & Kostumografi. Po ashtu depoziton në një dosje të veçantë testin teorik për secilin kandidat të sekretuar.
Në këtë specialitet komisioni e fillon punën e tij pas përfundimit të procesit të konkursit të konkurrentëve.
- d) Regji Filmi dhe TV**
Komisioni depoziton në një dosje të veçantë etydin regjisorial mbi baza fotografie për secilin kandidat për programin e studimit Regji Filmi dhe TV. Po ashtu depoziton në këtë dosje edhe platformën regjisoriale nga secilin kandidat gjatë konkurrimit.
- e) Koreografi**
Komisioni depoziton në një dosje të veçantë libretin koreografik të kandidatëve për programin e studimit Koreografi. Po ashtu xhiron me kamera edhe njërin prej materialeve koreografike që komisioni e gjykon të arsyeshëm për secilin kandidat.



- 4.9 Komisionet e Pranimit të Programit të Studimit pas vlerësimeve për çdo kandidat, të gjitha dosjet dhe kasetat me materialet e mësipërme ja dorëzojnë me procesverbal Titullarit të Fakultetit.
- 4.10 Lista përfundimtare me pikët respektive për të gjithë Programet e Studimit firmosen nga Titullari i Fakultetit dhe i dërgohet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Neni 5

Shpallja e fituesve

- 5.1 Shpalljen e listës së renditjes provizore të rezultateve për konkursin e pranimeve të pikëve e bën Dekani i Fakultetit.
- 5.2 Në rastin kur disa konkurrues kanë fituar të njëjtin numër pikësh, ata nënrenditen midis tyre sipas rendit zbritës të pikëve të fituara në testin special.

Neni 6

Regjistrimi për të fituar statusin e studentit

- 6.1 Kandidatët që shpallen fitues, duhet të regjistrohen për të fituar statusin e studentit.
- 6.2 Kandidatët që regjistrohen si student në Universitetin e Arteve duhet të paraqesin **dokumente origjinale**. Ato duhet të jenë në vartësi të Udhëzimeve të MAS.
- 6.3 Sekretaria duhet të pajisë kandidatin me një fletë të posaçme ku shënohet: numri i regjistrimit, emri i kandidatit si dhe data dhe ora e regjistrimit. Fleta e regjistrimit duhet të jetë e nënshkruar nga Dekani dhe Sekretarja e Fakultetit.
- 6.4 Gjithashtu në këtë regjistër duhet të nënshkruajë çdo kandidat fitues, i regjistruar më parë, por që kërkon të ç'regjistrohet nga kjo degë për arsye të ndryshme.
- 6.5 Kandidatit që ç'regjistrohet i kthehen vetëm dokumentet origjinale personale por jo pagesa e regjistrimit.
- 6.6 Regjistrimet e kandidatëve fitues për të gjitha kuotat kryhen pranë Sekretarisë së Fakultetit të Artit Skenik, në datat që do të përcaktojë Ministria e Arsimit dhe Sportit.

Neni 7

Rregulla për kandidatët

Gjatë konkursit, kandidati duhet të respektojë këto rregulla:

- 7.1 Kandidatët duhet të paraqiten në Fakultet ditën e parë të fillimit të konkursit në orën e përcaktuar në kalendarin e zhvillimit të konkurseve i shpallur në Fakultetin e Artit Skenik.
- 7.2 Kandidati do të paraqitet para Komisionit të Pranimit të Programit të Studimit në bazë të orarit që do të përcaktojë Komisioni i Programit të Studimit.
- 7.3 Mosparaqitja në bazë të këtij orari çon në s'kualifikimin e tij nga konkursi.
- 7.4 Konkursi është kolektiv dhe individual.
- 7.5 Kandidati duhet të shpërfaqë para Komisionit kërkesat që rrjedhin nga kriteret për çdo Program Studimi.



Adresa: Blv. "Deshmorët e Kombit", Sheshi "Nënë Tereza", Tiranë Shqipëri. Tel: +355 42 247 598, www.uart.edu.al

- 7.6 Nga ana tjetër komisioni krijon atmosferën e nevojshme që kandidati të shpreh aftësitë e tij.
- 7.7 Kandidati do të largohet nga konkurrimi vetëm kur komisioni t'ia kërkojë këtë gjë.

DEKANI

Prof. Kastriot Çaushti

